



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1498 / Prot. 2

Vlorë më, 30.05. 2025

VENDIM

Nr. 38, datë 30.05.2025

**PËR MIRATIMIN E TARIFËS VJETORE PËR PROGRAMET E STUDIMEVE PËR
TË GJITHA CIKLET PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërma ç, neni 6, pika 30, nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika 1, gërma i të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", VKM nr.288 21.05.2018 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një preogram të studimit të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", shkresës së Administratorit të UV-së nr.1195/3 prot, datë 30.05.2025, Vendimit nr.55 të Senatit Akademik, datë 21.05.2025 Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 30.05.2025

VENDOSI

1. Të miratojë tarifat e shkollimit për programet e studimeve për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Studentët e ciklit të parë të studimeve i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi.
 3. Studentët e ciklit të parë të studimeve në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që rezultojnë me notë mesatare nën 6 në përfundim të vitit të parë akademik e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit.
 4. Studentët të cilët rezultojnë me notë mesatare të vitit paraardhës mbi 6 (gjashtë) – 9 (nëntë) paguajnë ½ e tarifës së shkollimit.
 5. Studenti i ciklit të parë të studimeve i cilësuar përsëritës dhe vijon studimet në vitin pasardhës, i nënshtrohet tarifës për kredit për detyrimet apo lëndët përdëritëse, si dhe tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin ndjek studimet.
 6. Për studentët e ciklit të dytë të studimeve afatet dhe menyra e pagesës do të jetë në zbatim të vendimit të BA nr. 52 datë 19.11.2020.
 7. Për studentët që ndjekin një program të integruar të studimit afatet dhe mënyra e pagesës do të jetë në zbatim të vendimit të BA nr. 19 datë 11.05.2021.
 8. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

